

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Venhar Salihu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.P. nga fshati Pasjan, Komuna e Parteshit, të cilin me autorizim e përfaqëson Elmi Qerimi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Parteshit, Drejtoria Komunale e Arsimit të cilin e përfaqëson Rrustem Latifaj avokat nga Gjilani, me objekt kontesti pagimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të dt.25.09.2017, gjykata me datë 10.10.2017, mori këtë:

### **AKTGJYKIM**

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.P. nga fshati Pasjan, Komuna e Parteshit, e paraqitur kundër të paditurës Komunës së Parteshit, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe **DETYROHET** e paditura që të ia paguaj paditësit të ardhurat personale të pa paguara në shumë të përgjithshme të llogaritura në neto prej 1.290.78 € (njëmijë e dyqindënëntëdhjetë e shtatëdhjetë euro), për 6 (gjashtë) muaj nga 215.13 € për një muaj, sipas kontratës së punës Nr.169-1/14 e datës 03.01.2014, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm.
- II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Novëbërdës që paditësit S.P. nga fshati Pasjan ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 576.50 €.
- III. OBLIGOHET** paditësi S.P. nga fshati Pasjan që kësaj gjykate të i paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 50 € për padinë e paraqitur në këtë çështje.

### **Arsy et i m i**

Paditësi në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit pagimin e të ardhurave personale të pa paguara, duke theksuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë pune për kohë të caktuar duke filluar nga dt.01.01.2014 e deri më dt.31.08.2014. Paditësi po në bazë të kësaj kontrate është paguar vetëm për muajin Janar të vitit 2014, dmth e paditura nga muaji shkurt i vitit 2014 i ka ndërprerë pagesën e të ardhurave personale për paditësin. Gjithashtu e paditura, paditësit i ka paguar edhe muajin Korrik të vitit 2014 në shumë prej 215.13 €, por muajt paraprak dhe atë pas muajit të lartëcekur nuk i ka paguar dhe për këtë arsye, paditësi me dt.10.06.2014 kishte ushtruar ankesë për shkak të pezullimit të pagës nga ana e të paditurës, por e paditura nuk është përgjigjur në ankesë dhe për këtë arsye paditësi i është drejtuar gjykatës me këtë padi dhe nga gjykata ka kërkuar që pas administrimit të provave, kërkesëpadia e tij, të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura të i paguaj të ardhurat personale të pa paguara, për 6 muaj të pa paguara, sipas Kontratës së Punës Nr.169-1/14 e dt.03.01.2014, në shumë të përgjithshme prej 1.290.78 € si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## Kopetenca dhe juridiksioni i kësaj gjykate

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje bazuar në nenin 1 të LPK-ës, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur në këtë çështje konform nenit 17 pika 1 dhe 2, nenit 37.1, 38.1 lidhur me nenin 49 të LPK-ës, meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë me kontest nga marrëdhënja e punës dhe paditës është punëtori e gjithashtu puna është kryer në Pasjan, Komuna e Parteshit, që i bie të jetë në territorin e kësaj gjykate. Andaj, nga të lartcekurat, rezultoi që kjo gjykatë është kompetente për të gjykuar këtë rast juridiko-civil.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

## Rrjedha e Procedurës

Gjykata duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-ës, të paditurës i ka dërguar aktvendim për përgjigjen në padi, padinë së bashku me provat e bashkangjitura padisë me datë 23.09.2015, më qëllim që e njëjta të jep përgjigje në lidhje me pretendimet e paditësit, mirëpo e paditura nuk ka bërë përgjigjen në padi<sup>1</sup>.

Gjykata me aktvendimin procedural, ka filluar këtë çështje nga fillimi<sup>2</sup> dhe ka mbajtur seancën përgatitore dhe atë kryesore edhe atë me dt.16.05.2017 dhe 25.09.2017 të tjerat senaca janë caktuar por nuk janë mbajtur (për arsye të ndryshme).

## Pretendimet e palëve

**Paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij** në seancën përgatitore, kryesore dhe në shpjegimet përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se nga provat e elaboruara, është vërtetuar bazueshmëria dhe lartësia e kërkesëpadisë, sepse paditësi ka pasur Kontratë me Nr.169-1/14 të dt.03.01.2014, me të paditurën dhe e njëjta është realizuar përmes Ministrisë së Financave duke ju paguar paditësit të ardhurat personale (dy paga) përmes llogaris bankare në bazë të punës së realizuar, ndërsa të paditurit në mënyrë të kundërligjshme nuk i janë paguar 6 (gjashtë) paga nga 215.13 €, të gjitha këto në shumë totale 1290.78€. Andaj, nga këto arsye nga gjykata ka kërkuar që në tërësi të aprovohet kërkespadija e paditësit dhe të detyrohet e paditura që të i kompenzojë realizimin të ardhurat personale për pagat të pa paguara për 6 muaj nga 215.13 €, në shumë të përgjithshme prej 1,290.78 € si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë: për përpilim e padisë shumë prej 104€, për tri senaca të mbajtura dhe prezenturara nga 135 € si dhe për një senacë të shtyrë.

---

<sup>1</sup> Ky aktvendim është dërguar nga një gjyqtar tjetër dhe i njëjti ka caktuar dhe mbajtur senacë në lidhje me këtë çështje.

<sup>2</sup> Për shkak të ndrrimit të gjyqtarit, për më tepër shih proceverbalin e dt.16.05.2017.

**E paditura, përkatësisht i autorizuari i saj**, në seancën përgatiore, kryesore dhe në spjegimet përfundimtare ka kundërshtuar në tërësi padin dhe kërkespadinë e paditësit si të pa bazuar, duke shtuar se paditësi nuk ka krijuar mardhënje pune të rregullt pasi që në rastin konkret nuk është e qartë qfarë titulli të pozitës i njëjti ka pasur dhe për vendin e tij të punës as nuk është shpallur konkursi. Sa i përket Kontratës të Punës nr.169-1/14 të dt. 03.01.2014 i njëjti ka konstatuar këtë kontratë, me arsyetimin se kjo kontratë është fiktive dhe është lëshuar nga ish-drejtori i drejtorisë së arsimit M.J. i cili në kohën e lëshimit të kësaj kontrate nuk ka pasur mandat si drejtor e gjithashtu numri i protokollit në kontratë, nuk figuron as në librin e protokollit zyrtar në Komunen e Parteshit për vitin 2014. Sa i përket dy pagave të realizuara nga ana e paditësit i njëjti ka deklaruar se është e pa qartë dhe e pa besueshme se si ka mundur ti bëhet pagesa paditësit i cili nuk ka punuar. Andaj, përfaqësuesi i të paditurës mbi këtë bazë e ka kundërshtuar padinë dhe kërkespadinë e paditësit dhe nga gjykata ka kërkuar që ta refuzoj si të pa bazuar kërkespadinë e paditësit, kurse ka kërkuar që të paguhen shpenzimet e procedurës edhe atë për 7 senaca gjyqësore, por pa saktësuar se sa është shuma e kërkuar.

### **Provat e Administruara**

Gjykata për ti vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, për të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejt gjendjen faktike, dhe për të vepruar konform dispozitave procedurale dhe materiale ligjore në lidhje me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Kontratën e Punës nr.169-1/14 të dt.03.01.2014 e lidhur në mes DKA të Partesh dhe S.P.; Pasqyra Financiare në emër të S.P. lëshuar nga Raiffeisen Bank dt.18.08.2014; Ankesën e dt.10.06.2014 e paraqitur nga S.P. drejtuar DKA-Pasjan; Kopjen e Regjistrimit të Protokollit Zyrtar të Komunes së Parteshit; Dëgjimi i dëshmitarës V.J. si dhe dëgjimin e paditësit S.P. në cilësi të palës.

**Dëshmitarja V.J., në mes tjerash ka deklaruar:** se që nga shkurti i vitit 2014 është Drejtoresh në Drejtorin e Arsimit në Partesh dhe me të marrë detyrën kam ka hasur në parregullsi të trashëguara, nga se ish-Drejtori i DKA-Partesh Milivoje Jovanoqviq, i cili kishte lëshuar kontrata të parregullta pa shpallur konkurs dhe pas kadimit të mandatit si drejtor me dt.15.12.2013, në mesin e të cilave kontrata të parregullta ishte edhe ajo për paditësin nga se e njëjta nuk figuronte në librin e protokollit zyrtar të komunës për vitin 2014. Duke shtuar se këtë parregullsi e kishin kuptuar pas ardhjes së listave të pagave nga Ministria e Financave, me ç' rast unë në cilsi të drejtoreshës dhe kryetari i komunës kemi urdhëruar një zyrtarë të arsimit që të dal në terren dhe të shoh se si është gjendja reale. Nga të gjeturat e zyrtarit komunal kemi konstatuar se në mënyrë të parregullt ishin punësuar rreth 100 puntor të cilët kishin qenë në listën e pagave ndërsa kontratat e tyre nuk kan figuruar në librin e protokollit zyrtar të komunës. Duke e parë këtë gjendje ne si Komunë e Parteshit kemi marr vendim që ata persona që kan marr kontrata pune nga komuna e jonë pas datës 15 Dhjetor të vitit 2013 që t'ju ndërpritet mardhënja e punës respektivisht të ardhurat personale, duke përfshir edhe paditësin nga se i njëjti është pajisur me kontratë pasë kësaj date. E njëjta dëshmitare ka njoftuar gjykatën se ish drejtorin M.J. e ka paraqitur në polici, por një inspektor nuk e ka lënë që të paraqitet kallzim penal ndaj të njëjtit me arsyetimin se lënda ndaj të njëjtit drejtor

gjindet në polici. Kësaj dëshmitare gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që e njëjta ishte e sinqert, të thënat e saj ishin në përputhje të plotë me provat të tjera në lidhje me këtë çështje.

**Paditësi G.D., i dëgjuar në cilësi të palës në mes tjerash ka deklaruar:** se i njëjti nga viti 2011 është në mardhënje pune me Komunën e Parteshit, gjegjësisht shkollën fillore “Milladin Popoviq” në fshatin Pasjan, ku i njëjti akoma punon po në të njëjtën shkollë por të ardhurat personale nuk i merr, përkatësisht i njëjti ka marrë pagë deri në vitin 2014, më konkretisht për vitin 2014 i ka marrë dy paga edhe atë të muajit janar dhe korrik edhe për kundër faktit se ka pasur kontratë në fuqi nga Janari i vitit 2014 e deri më 31.08.2014. I njëjti ka deklaruar se nga Komuna e Parteshit nuk ka pranuar asnjë vendim lidhur me ndërprerjen e mardhënjës së punës apo të ardhurave personale dhe në momentin kur ka kuptuar se nuk po i paguhet të ardhurat personale, i njëjti ka paraqitur ankes tek e paditura, por përgjigje nuk ka pranuar. Kurse sa i përket pagës për muajt janar dhe korrik të vitit 2014 i njëjti ka deklaruar se i ka pranuar në llogarin bankare. I njëjti ka deklaruar se në këtë vend të punës ka hyrë me konkurs dhe në bazë të konkursit është pranuar. Gjithashtu i njëjti ka deklaruar se nga e paditura nuk ka pranuar asnjë vendim për ndërprerjen e marrëdhënjës së punës apo të ardhurave personale. Deklaratës së paditësit, gjykata ia fali besimin e plotë, me arsyetimin se i njëjti ishte i sinqertë, të thënat e tij ishin në përputhje të plotë me provat e tjera materiale dhe personale të cilat janë administruar.

Gjykata, përkatësisht gjyqtari i çështjes pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkespadija e paditësit është e bazuar.

#### **Vërtetimi i gjendjes faktike nga provate e administruara**

Duke i vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: paditësi me datën 03.01.2014 ka lidhur kontratën e punës Nr.169-1/14 Drejtorin e Arsimit në Komunën e Parteshit në kohëzgjatje prej datës 01.01.2014 deri më datën 31.08.2014<sup>3</sup>. Paditësit nga kontrata e lartëcekur i janë paguar dy paga dhe atë për muajt Janar ( shuma prej 172.74€) dhe korrik (shuma prej 215.13 €) të vitit 2014 (fakt ky, i cili vërtetohet sipas pasqyrës financiare–bankare të paditësit). Paditësit nuk i’jan paguar edhe 6 (gjashtë) paga mujore sipas kontratës së punës (fakt ky i vërtetuar nga pasqyra financiare dhe dëgjimi i paditësit në cilësi të palës). Paditësi i pa knaqur me mos pagesën e të ardhurave personale, me dt.10.06.2014 ka paraqitur ankesë pranë Komunës së Parteshit dhe ka kërkuar arsyet e mospagesave të të ardhurave personale, por asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje lidhje me këtë ankesë ( fakt ky, vërtetohet nga ankesa e paditësit drejtuar të paditurës). Nga dëgjimi i të paditurit gjykata ka vërtetuar edhe faktin se i njëjti nga e paditura nuk ka pranuar vendim për ndërprerjen e punës apo të ardhurave personale.

Nga dëgjimi i dëshmitarës V.J., gjykata vërtetoi faktin se e njëjta pas marrjes së drejtimit të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Parteshit në shkurt të vitit 2014 ka hasur në

---

<sup>3</sup> Këtë fakt gjykata ka vërtetuar nga Kontrata e Punës si dhe nga dëgjimi i paditësit në cilësi të palës.

pa rregullsi të shumta në mesin e të cilëve kanë qene edhe kontrata fiktive pa shpallur konkurs si dhe nënshkrimi pas përfundimit të mandatit të drtejorit paraprak në drejtorin e lartëcekur. Gjithashtu dëshmitarja pas marrjes së mandatit të drejtorisë ka kuptuar se paditësi dhe shumë të tjerë kanë qenë në listat e pagave dhe se e njëjta së bashku me Kryetarin e Komunës kanë urdhëruar një zyrtari që të dal dhe të shkoj ta vizitoj shkollën, ku ky zyrtarë ka konstatuar se dikund rreth 100 puntorë të arsimin në Komunën e Parteshit kanë qenë në listat e pagave por të njëjtit nuk kanë qenë në vendin e punës. Duke parë këtë gjendje në këtë komunë të gjithë personave të cilët kanë marrë kontratë pune pas dhjetorit të vitit 2013 kanë marrë vendim që ti ndërpritet marrëdhënja e punës, rrespektivisht të ardhurat personale, duke përfshirë edhe tani paditësin. Gjithashtu nga kjo dësmitare gjykata vëretoi faktin se ndaj paditësit nuk është udhëhequr ndonjë procedurë dicipline që të njëjtit ti shkëputet marrëdhënja e punës e rrjedhimisht edhe ti ndërpritet të ardhurat personale.

### **Dispozitat ligjore të zbatuara me rastin e marrjes së vendimit**

Në rastin konkret, gjykata duke vërtetuar gjendjen faktike si më lart të shpjeguar dhe pasi që vërtetoi faktin se paditësit i janë ndërprerë të ardhurat personale nga muaji shkurt i vitit 2014 edhe për kundër faktit se i njëjti ka pasur kontratë pune deri më dt.31.08.2014, paditësi përveq muajit janar të vitit 2014 ka marrë page në shumë prej 215.13€ edhe për muajin korrik të të njëjtit vit në një të anë, kurse duke u bazuar në dispozitat e poshtëcekura në anën tjetër, gjykata vendosi (si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi) që ta aporovoj si të bazuar kërkespadinë e paditësit dhe ta detyroj të paditurën që të i paguaj shumën prej 1.290.78 €, për 6 muaj, nga 215.13 €, për një muaj (pasi që në rastin konkret është vërtetuar se paditësi ka marrë dy paga në bazë të kontratës, kurse paga e fundit ka qenë shuma prej 215.13 €. Ndërpreja e të ardhurave personale nga ana e të paditurës është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 70 të Ligjit të Punës e cila dispozitë në paragrafin 3, parasheh që **“Pundhënësi duhet të mbaj takim me të punsuarin për të ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim të ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vetë”**. Nga provat e administruara si më lartë nuk është vërtetuar se punëdhënësi përkatësisht e paditura në rastin konkret ka zbatuar këtë dispozitë ligjore siç e ka paraparë ligjvënësi, ku në këtë rast nuk është plotësuar asnjë kushtë ligjor i kësaj dispozite për ndërprerjen e mardhenjes së punës. Edhe po të plotësohej ndonjë kushtë ligjor në dispozitën e lartëcekur e paditura prap nuk ka respektuar as dispozitën e ninit 71 paragrafi 2 i Ligjit të Punës e cila dispozitë parashe se **“punëdhënsi mund të ndërpres kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftimin prej 30 ditësh kalendarike të punësuarit”**, gjithashtu përveç dështimit të respektimit të kësaj dispozite ligjore nga e paditura nuk është respektuar as dispozita e ninit 72 të Ligjit të Punës mbi procedurat para ndërprerjes së kontratës, ku në paragrafin 1 të kësaj dispozite është paraparë: **“Vendimi për të ndërprer kontratën e punës duhet të bëhet më shkrim dhe duhet të përfshij arsyetimin për ndërprerje”**, e në rastin konkret si prove gjyktës nuk i është dorëzuar asnjë vendim për ndërprejen e punës e të ardhurave personale për paditësin, por paditësi ka deklaruar se i njëjti asnjëher nuk ka pranuar nga e paditura ndonjë vendim mbi ndërprerjen e kontratës së punës (deklaratë të cilës gjykata i aka falur besimin).

Gjithashtu gjykata në rastin konkret, duke u bazuar në nenin 80 pika 1, nën pika 1.1 të Ligjit të Punës ka konstatuar se paditësit në mënyrë të joligjore i është ndërprerë kontrata e punës dhe rrjedhimisht edhe të ardhurat personale, ku pika 1 e dispozitës së lartëcekur ka paraparë " Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: kurse pika 1.1 ka paraparë, " t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit", andaj gjykata vendosi që paditësit ti paguhen 6 ( gjashtë) paga mujore të pa paguara në shumë prej 1.290.78 €.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, pasi që në rastin konkret paditësi ka patur sukses në këtë procedurë, kurse e paditura si humbëse dhe për këtë arsye, gjykata konform nenit të lartëcekur e obligoi të paditurën që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 576.50 € dhe atë: shumë prej 104 € për përpilimin e padisë, 3 seanca të mbajtura dhe të prezantuara shumë prej 405 € (nga 135 € për një seancë, për seancat e dt.20.10.2015, 16.05.2017 dhe 07.08.2017) si dhe shumë prej 67.50€ për një senacë të shtyrë nga ana e përfaqësuesit të të paditurës (senacën e dt.18.09.2017), të gjitha këto të llogaritura sipas TOA të Kosovës.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi që i padituri te paguaj taksën gjygjësore për padi shumë prej 50 €, për shkak se i njëjti nuk kishte paguar këtë taksë në momentin e paraqitjes së padisë, edhe për kundër faktit se kemi të bëjmë me kontest nga marrëdhënja e punës po në bazë të nenit 7.1 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/02 për Unifikimin e Taksave Gjygjësore ku është paraparë se në kontestet e punës kur kemi të bëjmë me kërkesa me para duhet të paguhet taksa gjygjësore. Shuma për këtë taksë është përcaktuar konform nenit 10.1 të udhëzimit të lartëcekur.

Gjykata vlerësoi edhe të dhënat e të paditurës sa i përket se në rastin konkret, Kontrata e Punës është fiktive dhe e njëjta është lidhur, përkatësisht paditësi është pranuar në punë pa konkurs, por të njëjtat pretendime për gjykatën nuk ishin relevante, pa si që në rastin konkret Kontrata e Punës Nr.169-1/14, dt.03.01.2014 ka qenë e lidhur në mënyrë të rregullt, e njëjta është e protokoluar dhe e nënshkruar, kurse e paditura me asnjë provë të vetme nuk ka dëshmuar se në lidhje me këtë kontratë është shpallur fajtor ndonjë person apo ish drejtori i drejtoratit të arsimit apo kontrata e lartëcekur është shfuqizuar apo është ndërprerë në mënyrën e paraparë ligjore. Gjithashtu gjykata vlerësoi dhe admnistroi si provë edhe një faqe të Librit të Evidencave të Protokollit të Komunës së Parteshit me të cilën pretendohet të vërtetohet faktin se kontrata e lidhur me paditësit dhe të paditurës ka qenë fiktive, mirpo për gjykatën kjo nuk është e mjaftueshme sepse kjo provë ngelet e vetme dhe e pa mbështetur me provat tjera dhe veprimet ligjore të cilat është dashur ti respektoj e paditura e në rastin konkret e njëjta nuk i ka respektuar, siç tham edhe me lartë paditësi ka

themeluar mardhenje pune me një institucion kredibil (me siguri të lartë juridike dhe zbatimin e ligjeve) siç është Komuna, dhe për këtë kontratë i padituri është kompensuar për dy muaj janar dhe korrik të vitit 2014 dhe se e njëjta kontratë ka qenë në fuqi, kurse të ardhurat personale apo marrëdhënja e punës nuk janë ndërprerë në mënyrën ligjore të paraparë, por në mënyrë të njëanshme dhe pa respektuar asnjë rregull, andaj edhe për këtë arsye të njëjtat predeentime nuk u murrën për bazë nga ana e gjykatës.

Andaj, nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 2 lidhur me nenet 142 pika 1 dhe 2, nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**C.nr.587/14, dt.10.10.2017**

**Gjyqtari**  
Venhar SALIHU

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.